



# Përditësimi i këshillës për shtrirjen e vaksinimit kundër COVID-19

17 qershor 2021

Ekspertët mjekësorë në Australi tani rekomandojnë vaksinën Pfizer COVID-19 për të rriturit nën 60 vjeç. Këshilla e mëparshme mjekësore ishte se vaksina Pfizer ishte më e preferuar për të rriturit e moshës nën 50 vjeç.

Kjo këshillë e përditësuar është e bazuar në dëshmi të reja që tregojnë se ka më shumë rrezik të një gjendjeje të rrallë të mpiksjes së gjakut tek grupi i moshës 50-59 sesa që kishim menduar në fillim. Kjo gjendje quhet trombozë me sindromën trombocitopeni apo TTS.

Vaksina AstraZeneca do t'u jepet njerëzve të moshës 60 vjeç e lartë. Për njerëzit e moshës 60 vjeç e lartë, përfitimet e vaksinimit tejkalojnë rreziqet e TTS.

Marrja e vaksinës mbetet mënyra më e rëndësishme për të parandaluar sëmundjen apo vdekjen nga COVID-19. Disa miliona njerëz nëpër botë kanë marrur vaksinat në mënyrë të sigurt.

Njerëzit që kanë marrur dozën e parë të vaksinës AstraZeneca kundër COVID-19 pa ndonjë efekt serioz anësor duhet të marrin dozën e dytë. Kjo përfshin të rriturit e moshës nën 60 vjeç.

Marrja e dozës së dytë ju jep mbrojtjen më të mirë nga të sëmurit seriozisht nga COVID-19. Nëse keni marrur dozën e parë duhet të caktoni termin për dozën e dytë.

Klinikat qeveritare për vaksinim që veçmë kanë dhënë vaksinën Pfizer menjëherë do të fillojnë të pranojnë njerëzit e moshës 50-59 vjeç për Pfizer.

Njerëzit në Australi mund të jenë të sigurt se ekspertët tanë mjekësorë vazhdojnë të mbikëqyrin të dhënat dhe evidencën në vend dhe nga jashtë vendi. Rekomandohet që secili që ka të drejtë duhet të merr vaksinë kundër COVID-19.

Për të caktuar termin për vaksinim vizitoni [health.gov.au](https://www.health.gov.au)

## Për më shumë informacione

Nëse keni pyetje në lidhje me vaksinat kundër COVID-19, bisedoni me mjekun tuaj, vizitoni [www.health.gov.au/covid19-vaccines-languages](https://www.health.gov.au/covid19-vaccines-languages), apo thirrni Linjën Kombëtare për ndihmë për koronavirus në **1800 020 080**. Për shërbime përkthimi dhe interpretimi thirrni **131 450**.